



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1523/2 prot

Datë 04.07.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-66562-04-19-2023, me objekt: Loti 5 “*Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Fier*”, me fond limit 21.673.080 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 13.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “NRG” SHPK
Farkë, Rruga “Eduart Mano”, Pallatet Nr.10, Kopshti Zologjik, Selitë, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nd.1, 1001, Tiranë
- Subjekte të Interesuara:** “Egian Med” SHPK
Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga e Kavajës, Godina “Condor Centre”, Kati 4, Tiranë

Në datën 03.07.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur ankesa me nr. 1523 prot., datë 03.07.2023 e operatorit ekonomik “NRG” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-66562-04-19-2023, me objekt: Loti 5 “*Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Fier*”, me fond limit 21.673.080 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 13.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) **pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.**”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “NRG” SHPK me anë të ankesës me nr. 1523 prot., datë 03.07.2023, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “Egian Med” SHPK, të kriterëve si më poshtë:

- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ose dokumentin e rregjistrimit vetëm në rastin e produkteve biocide në një prej vendeve e percaktuara ne Ligjin 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide ne shëndetin publik”.*
- *Operatori ekonomik duhet te provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për lëndët biocide që do të kryhet shërbimi objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit te Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, e-mail, Ëëbsite kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*
- *Operatori ekonomik duhet te paraqesë etiketat/katalogët/skedarat teknike dhe Dokumentin e te dhënave të Sigurisë për të gjitha produktet biocide ose jo biocide (barriera fizike etj.) në gjuhën shqip dhe anglisht.*
- *Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se do të sigurojë shërbimin ËëEB GIS me editim nga interneti për ndërtimin e hartave dixhitale sipas përcaktimeve në specifikimet teknike.*

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike per Lotet 1, 2, 4, 5

I. Të dhëna të përgjithshme

Procesi i dezinfektimit të mushkonjave do të bazohet në një program parandalimi dhe kontrolli, i cili synon uljen e dendësisë së mushkonjave në zonat e përzgjedhura nëpërmjet kontrollit të larvave me larvicide dhe/ose barriera fizike, apo nëpërmjet eliminimit të vatrave të zhvillimit të mushkonjave në fazën ujore.

Avantazhet që paraqet kontrolli në fazën ujore:

- larvat kapen më lehtë pasi ato nuk mund të largohen nga vendi i zhvillimit /vatra me ujë;
- larvat brenda vatrës ose zonës me ujë qëndrojnë të izoluara aty për një kohë relativisht të gjatë (nga 7 deri në 14 ditë);
- mund të trajtohen në çdo kohë;
- në një zonë të vogël, të kufizuar mund të jenë të përqendruara një numër i madh larvash;
- efekti i larvicideve ka një kohëzgjatje të madhe krahasuar me adulticidet: larvave të sapoçelura nga vezët, u nevojiten zakonisht mesatarisht deri në dy javë që të realizojnë plotësisht ciklin e tyre të zhvillimit në ujë dhe të dalin në fluturim, periudhë në të cilën larvicidi vazhdon efektin e tij, ndërsa aplikimi i adulticidit mund të jetë i nevojshëm të përsëritet brenda 24 orëve, për shkak të emigrimit të mushkonjave në territorin përreth.

Sipërfaqet që do të trajtohen do të jenë vatra të përhershme dhe/ose të përkohshme, me ujë dhe me larva të mushkonjave në laguna, parqe kombëtare dhe publike, kanale, pellgje, zona urbane hapësira publike dhe private, puseta, bodrume, gropa septike, etj. Trajtimet do të kryhen bazuar në specifikimet teknike, gjetjet dhe konfirmimet e pranisë së larvave në terren me anë të monitorimit entomologjik, para çdo trajtimi.

Në zonat urbane shqetësim përbëjnë kryesisht mushkonjat e gjinisë *Aedes* dhe *Culex* të cilat njihen edhe për rolin e tyre vektorial në transmetimin e patogjenëve si virusin e Nilit Perëndimor (ËNV), virusin Chikungunja, Dengue, ZIKA etj. ndërsa në zonat bregdetare gjithashtu edhe ato të gjinisë *Anopheles* (vektor të malaries), *Aedes* (*Ochlerotatus*) që shkaktajnë shumë bezdisje me pickimet e tyre sidomos në muzg, etj.

II. Llojet e ndërhyrjeve të rekomanduara për kontrollin e larvave të mushkonjave dhe specifikimet teknike sipas habitateve

A. Trajtime periodike me larvicide në Zona të Mbrojtura Natyrore (ZMN) vatra të përkohshme dhe të përhershme në laguna, parqe, kanale, pellgje etj, sipas zonave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Trajtimet kryhen, në periudhën Prill/Maj deri në Shtator/Tetor të çdo viti kalendarik, pra për një periudhë kohe të pritshme mesatare prej 6 muajsh/vit, me kërkesë të AK.

Çdo cikël trajtimi në habitatet e mësipërme të përfundojë brenda 48 orëve nga data e fillimit, për të shmangur daljen në fluturim të adulteve të llojeve të mushkonjave që zhvillohen në këto habitate.

Data e saktë e fillimit dhe e përfundimit të punës do të përcaktohet nga AK për çdo trajtim.

Vendet potenciale të shumimit të larvave të mushkonjave ku nuk konfirmohet prania e larvave apo të cilat janë të thata nuk duhet të trajtohen.

Organizimi i shërbimit dhe të gjitha procedurat e nevojshme për realizimin në kohë dhe me cilësi është përgjegjësi e OE.

Në vatrat e përhershme të zhvillimit të larvave, inspektimi para trajtimit duhet të bëhet çdo dy javë. Në vatrat e përkohshme të shumimit të larvave, inspektimi duhet të bëhet brenda 24-48 orëve pas reshjeve, baticës ose përmytjeve natyrore/artificiale.

Për trajtimin e lagunave, parqeve, kanaleve, pellgjeve punonjësit e OE që kryejnë shërbimin duhet të jenë të paisur me aparat GPRS për të transmetuar në platformën ëeb-GIS në kohë reale vend-ndodhjen (pozicionin gjeografik) e tyre, gjatë kryerjes së trajtimit. Është përgjegjësi e OE mbajtja e aparateve GPRS vazhdimisht në gjendje funksionale dhe të ndezura gjatë kryerjes së shërbimit dhe përshtatja për transmetimin në platformën ëeb-GIS të të dhënave lidhur me pozicionin gjeografik (latitudo, longitudo) dhe mbulimin e zonës në hartë gjatë kryerjes së trajtimit. Shërbimi kryhet gjatë orëve të ditës.

✓ Produktet larvicide që duhet të përdoren

Shërbimi i dezinfektimit në habitatet e mësipërme përfshin zonat bregdetare dhe urbane. Lagunat bregdetare të vendit tonë janë zona të mbrojtura natyrore nga konventa kombëtare dhe ndërkombëtare dhe të gjithë kanalet që trajtohen në zonën bregdetare derdhen drejtpërdrejt ose indirekt në det.

*Produktet larvicide që duhet të përdoren për trajtimin e habitateve të mësipërme nuk duhet të jenë toksike/të rrezikshme për organizmat ujorë dhe tokësorë jo target dhe nuk duhet të jenë të dëmshëm për njerëzit, kafshët, dhe mjedisin, dhe me efikasitet jo më pak se sa dy javë. Këto të dhëna tregohen në Dokumentin e të Dhënave të Sigurisë së Produktit (ose MSDS), dhe në etiketë. Në zonat e mbrojtura natyrore, për të ruajtur mjedisin e ndjeshëm pranohet vetëm përdorimi i produkteve larvicide me lëndë vepruese *Bacillus thuringensis israeliensis (B.t.i.)*, ose *Bacillus thuringensis israeliensis (B.t.i.)* i kombinuar me *Bacillus sphaericus* ose ekuivalent, me kusht që ekuivalenti të mos dëmtojë dhe të mos jetë toksik për gjallesat e tjera dhe të jetë me efikasitet të provuar dhe kohëzgjatje të aktivitetit prej të paktën 2 javësh në habitatet specifike.*

Në vatrat ujore që janë të mbuluara me shumë bimësi depërtimi i formulimeve lëng mund të pengohet nga bimësia. Në këto kushte, të përdoret formulim në gjendje të thatë (ose Granula), i cili depërton bimësinë duke arritur deri në vatrën ujore.

Në vatrat ku është e vështirë të kryhet trajtimi nga toka, mund të kryhen aplikime nga ajri.

Është përgjegjësi e OE të ketë njohuri të plota për produktin larvicid biocid, dozat e përdorimit, efektet në mjedis dhe shëndet. OE duhet të kryejë trajtimin me produktet larvicide që ka ofertuar, si dhe duhet të kryejë kalibrimin e pajisjeve për të siguruar hedhjen e dozës së nevojshme për të arritur efikasitetin maksimal, por pa dëmtuar mjedisin, organizmat ujorë e tokësorë jo target dhe shëndetin e njerëzve. Ngordhja e larvave në vatrat e trajtuara, duhet të jetë në masën 100%. Nëse gjatë procesit të monitorimit entomologjik pas trajtimit, do të gjenden larva të gjalla, OE duhet të ritrajtojë menjëherë vatrat ku gjenden larva të gjalla me shpenzimet e tij financiare, që nuk mbulohen nga AK.

OE duhet të dorëzojë:

- një raport me informacionin sipas formatit të përcaktuar nga AK;
- hartën e zonave përkatëse (sipas hartës digjitale) para dhe pas trajtimit të printuar me ngjyra;
- gjurmët elektronike.

Produktet Biocide autorizohen në vendin tonë sipas VKM nr 933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”.

B. Trajtime periodike me larvicide në puseta dhe bodrume me ujë.

Trajtimet kryhen në periudhën nga Prill/Maj deri në Shtator/Tetor të çdo viti kalendarik, pra për një periudhe kohe të pritshme mesatare prej 6 muajsh, me kërkesë të AK.

Data e saktë e fillimit dhe e përfundimit të punës përcaktohet nga AK.

Trajtimi i bodrumeve dhe pusetave me ujë, kryhet një herë në muaj, sipas zonave të përcaktuara nga AK.

Organizimi i shërbimit dhe të gjitha procedurat e nevojshme për realizimin në kohë dhe me cilësi është përgjegjësi e OE.

Trajtimi i bodrumeve dhe pusetave me ujë të përfundojë brenda një periudhe 2-3 ditore nga momenti i fillimit të trajtimit (vetëm në rast se përcaktohet ndryshe nga AK).

- *Gjatë trajtimit të pusetave OE duhet të mbajë aparatën GPRS vazhdimisht të ndezura dhe në gjendje funksionale gjatë kryerjes së shërbimit për transmetimin në platformën ëeb-GIS të dhënave (apicall) që gjenerohen, lidhur me vend-ndodhjen (pozicionin gjeografik latitude, longitude) gjatë realizimit të shërbimit.*

OE është përgjegjës për menaxhimin e të dhënave të gjeoreferencuara dhe përshtatjen e tyre për ngarkimin në strukturën e të dhënave të standardizuara në platformën ëeb-GIS.

- *Për trajtimin e bodrumeve punonjësit e OE që kryejnë shërbimin duhet të jenë të paisur me aparat GPRS për të transmetuar në platformën ëeb-GIS në kohë reale vend-ndodhjen (pozicionin gjeografik) e tyre, gjatë kryerjes së trajtimit. Është përgjegjësi e OE mbajtja e aparateve GPRS vazhdimisht në gjendje funksionale dhe të ndezura gjatë kryerjes së shërbimit dhe përshtatja për transmetimin në platformën ëeb-GIS të të dhënave lidhur me pozicionin gjeografik (latitude, longitude) dhe mbulimin e zonës në hartë gjatë kryerjes së trajtimit.*

OE duhet të dorëzojë:

- *një raport me informacionin sipas formatit të përcaktuar nga AK;*
- *hartën e zonave përkatëse (sipas hartës digjitale) para dhe pas trajtimit të printuar me ngjyra;*
- *gjurmët elektronike.*

Efekti i pritshëm i shërbimit në bodrume dhe puseta me ujë duhet të jetë jo më pak se katër javë.

✓ Produktet larvicide që duhet të përdoren

*Bazuar në sa më sipër për trajtimin e pusetave dhe bodrumeve rekomandohet të përdoren produkte larvicide me lëndë vepruese *Bacillus thuringensis israeliensis* (B.t.i.) i kombinuar me *Bacillus sphaericus* ose barriera fizike njëstresore ose ekuivalent me efikasitet të provuar dhe kohëzgjatje të aktivitetit prej të paktën katër javësh në habitatet specifike. Këto të dhëna tregohen*

në Dokumentin e të Dhënave të Sigurisë së Produktit (ose MSDS), dhe/ ose në etiketë, dhe ose katalogun përkatës.

Është përgjegjësi e OE të ketë njohuri të plota për produktin larvicid, dozat e përdorimit, efektet në mjedis dhe shëndet. OE duhet të kryejë trajtimin me produktet larvicide që ka ofertuar, si dhe duhet të kryejë kalibrimin e pajisjeve për të siguruar hedhjen e dozës së nevojshme për të arritur efikasitetin maksimal, por pa dëmtuar mjedisin dhe shëndetin e njerëzve. Ngordhja e larvave në vatrat e trajtuara duhet të jetë në masën 100%. Nëse gjatë procesit të monitorimit entomologjik pas trajtimit, do të gjenden larva të gjalla, OE duhet të ritrajtojë menjëherë vatrat ku gjenden larva të gjalla me shpenzimet e tij financiare, që nuk mbulohen nga AK.

Produktet Biocide autorizohen në vendin tonë sipas VKM nr 933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”.

Të tjera

OE është përgjegjës për sigurinë e punonjësve të tij dhe sigurimin e veshjeve personale mbrojtëse për realizimin e shërbimit.

OE është përgjegjës për çdo dëmtim të mjedisit dhe mban përgjegjësi sipas legjislacionit në fuqi. Punonjësit duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi dhe të përdorin veshje të dukshme me tregues të qartë të emrit dhe ose logos së kompanisë.

Është përgjegjësi e OE sigurimi dhe paraqitja e dokumentacionit që provon kapacitetet e tij teknike lidhur me pajisjet që do të përdorë për realizimin e trajtimeve, metodologjinë e trajtimit, produktin larvicid që do të përdor, duke i listuar dhe përshkruar specifikimet teknike të përdorimit të tyre sipas habitateve të pritshme për trajtim dhe produkteve larvicide/biocide me të cilat parashikon të kryej trajtimin.

.....

Shënim: *Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1), të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në atë Lot ku oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.*

.....

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të Kontratës, në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit të këtij loti. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si me poshtë:

- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet e lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, **ose** faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

.....

- I. Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit, objekt prokurimi duhet të ketë te punësuar staf si me poshte:
 - a) **1 (një) Drejtues Teknik.** Për drejtuesin teknik te paraqitet:
 - Kontrate pune me profil Agronom/Shëndet Publik/Biologji/Kimi.
 - **Minimalisht 2 (dy) punonjës.** Për punonjësin të paraqitet:
 - Kontrate pune perkatese.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 04.07.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiovent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri